



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:049049  
Datë: 18.04.2024  
Numri i dokumentit: 05591075

**AC-I-23-0300**

***Në çështjen juridike të:***

***Paditësja***

**S R Sh**, të cilën e përfaqëson Sh R Prizren.

***Kundër:***

***E paditura/Ankuesja***

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" Nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës të DHPGJSK-së C-IV.-23-0070, të datës 02 maj 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV.-23-0070 i datës 02 maj 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 19 mars 2015, paditësja parashtroi ankesë në DHPGJS kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH-së D.L.B "Lavërtari-Blegtori"-Prizren, e administruar nga AKP, PRZ009-0250(AL i AKP-së) të datës 06 mars 2015. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara, për periudhën kohore nga viti 2004 deri në vitin 2014, në shumë prej 5.248.00 euro. Parashtruesja ka theksuar se më 15 mars 2005, në bazë të nenit 615 të LMD-së, kishte lidhur kontratë mbi veprën me të paditurën për kryrejen e punëve të kontabilitetit, financiar-bilancin përfundimtar. Në bazë të kësaj kontrate, e paditura ka marrë për obligim që paditësit t'ia paguajë shumën prej 150 euro për çdo muaj, dhe e paditura për periudhën e cekur i ka mbetur borxh në shumën prej 5.248.00 euro.

Më 9 qershor 2021, e paditura ka parashtuar përgjigjen ndaj padisë kundër vendimit të ankimuar, me ç'rast rikonfirmoi arsyet për refuzimin e kërkesës kreditore si në vendimin e kundërshtuar, dhe i propozoi gjykatës që të refuzohet padia si e pa pranueshme, apo e pa bazuar dhe të lihet në fuqi vendimi i kundërshtuar.

Më 02 shtator 2021, Shkalla e parë e DHPGJS-së kishte marrë Aktgjykim C-IV.-15-0253, me të cilin ishte refuzuar si e pa bazuar ankesa/kërkesëpadia e paditëses dhe ishte vërtetuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj Vendimi i AL të AKP-së PRZ009-0250, i datës 06 mars 2015. Bazuar në arsyetimin e dhënë, parashtruesja e kërkesës kreditore, nuk i ka prezantuar gjykatës asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se ka kryer ndonjë punë për të paditurën, brenda periudhës kohore të pretenduar. Ajo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se ka inicuar ndonjë procedurë në një gjykatë apo organ tjetër administrativ, para dorëzimit të kërkesës kreditore të Autoriteti i Likudimit. Sipas kontratës mbi vepër nr.37, të datës 15 mars 2005, rezulton se e paditura me paditësin kishin kobntraktuar kryerjen e punëve të kontabilitetit "për kohë të caktuar"- neni 1 dhe 2, ndërsa sipas nenit 4 të kësaj kontrate "shumën prej 150. Euro".

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga mënyra se si është ndërtuar kontrata mbi vepër nr. 37 e datës 15 mars 2005, rezulton se paditësja dhe e paditura janë pajtuar për kryerjen e punëve të kontabilitetit për kohë të caktuar dhe se në emër të kryerjes së këtyre punëve porositësi- tani e paditura, kryersit të

punëve duhet t'ia paguaj 150 euro, dhe në këtë kontratë nuk është përcaktuar obligimi i të paditurës që paditëses në emër të punëve të kryera, t'ia paguajë "në çdo muaj" shumën prej 150.00 euro, sikurse paditësja pretendon në ankesë. Nga mbrojtja e të paditurës rezulton se paditësja nuk kishte statusin e punëtores në marrëdhënien e punës në kohë të pa caktuar, që konform nenit 10.4 të rregullorës 2003/13 dhe nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, gëzon të drejtën në përfitimin prej 20% të ardhurave të përfituara nga shitja e asetëve në privatizim, apo likudim të të paditurës. Paditësja prej vitit 2004, përkatësisht përgjatë periudhës kohore të pretenduar, nuk kishte punuar dhe kështu nuk kishte krijuar të ardhura për të paditurën për çka do të kishte fituar të drejtën edhe në të ardhura personale- qoftë edhe për pagën minimale. Lidhur me pagat e pretenduara si të pa paguara për periudhën kohore të vitit 2004 e deri në vitin 2013, para se të inicohej procedura e likudimit e të paditurës, paditësja nuk kishte inicuar ndonjë procedurë gjyqësore apo para ndonjë organi tjetër, për realizimin e këtyre të drejtave. Në arsyetimin e vendimit gjykata potencon se paditësja me të paditurën kishte lidhë një kontratë mbi vepër për kohë të caktuar, prandaj nuk gëzon mbrojtjen juridike, sipas dispozitave të nenit 10.4 të Rregullores nr.2003/13 dhe të dispozitave të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 për AKP-në.

Më 16 tetor 2021, ankuesja parashtroi ankesë në DHPGJS kundër këtij aktgjykimi për shkak të të gjitha arsyeve ankimore. Ankuesja pretendon se faktet lidhur me borxhin sipas kontratës për vepër dhe provat tjera lidhur me ekzistimin apo jo të detyrimit monetar, janë fakte vendimtare, gjë që me aktgjykimin e ankimuar janë bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale. Ankuesja konsideron se sipas formulimit të kontratës dhe nga përmbajtja e saj, rezulton se paditësja i ka kryer punët sipas porositesit, për çdo vit, duke fillur për vitin 2005 deri më 25 prill 2014, dhe në bazë të pagesave përmes arkës dhe bankës, paditëses i janë paguar 10.780.33 euro, ndërkaq ka mbetur për pagesë 5.248.00 euro. Ankuesja konsideron se bazë të nenit 8 të LDHP-së, si dhe neneve 332 dhe 333 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjykata me aktvendim e thërret palën tek e cila gjendet dokumenti, që në afat të arsyeshëm gjykatës t'ia paraqet dokumentin-shkresen. Kështu pala e paditur ka për obligim që gjykatës t'ia dorëzojë prove përmbushjen e detyrimit monetar sipas kontratës për vepër, sepse këto prova gjenden tek e paditura, që janë në ruajtje tek AKP-ja. Gjykata e shkallës së parë konstaton se paditësja paraprakisht nuk ka inicuar ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë

organi tjetër për realizimin e këtyre të drejtave. Në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, asnjë kreditor nuk mundet t'i realizoj të drejtat e tij-detyrimet obligative të ndërsjellta ndaj NSh-së, kur palët kanë lidhur raport juridiko-civil, pa hapjen e procedurës së likudimit nga AKP, Prandaj pretendimi i të paditurës dhe konstatimi i gjykatës se paditësi nuk ka inicuar rast gjyqësor apo administrativ, është terësisht si i pa pranueshëm. Ankuesja konsideron se AL i AKP-së nuk ka mundur që ta aplikoj nenin 608 të të Ligjit të Punës së Bashkuar për faktin se Ligji i AKP-së është ligj special që i mbizortëron ligjet tjera. Ankesja ka propozuar që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe të urdhërohet Autoriteti i Likudimit që paditëses t'ia paguajë borxhin e mbetur sipas kontratës për vepër, në shumë prej 5.248.00 euro me kamatë të llogaritur sipas nenit 37 të Ligjit për AKP-në dhe të obligohet me shpenzimet e procedurës në shumë prej 330.00 euro apo ky aktgjykim të priset dhe çështja të ktheht në rigjykim.

Më 04 tetor 2022, e paditura në përgjigjen e saj i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të paditëses si të pa bazuara dhe propozon që ankesa të refuzohet, dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 16 shkurt 2023, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-21-0679, ankesën e paditëses e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë dhe lëndën e kthen në rigjykim tek gjyqtari përkatës i Shkallës së I-rë. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se paditësja kishte dorëzuar kërkesë kreditore tek AL i AKP-së në emër të pagave të pa paguara në shumën prej 5.248,00 euro. Në vazhdim të arsyetimit thuhet ndër të tjera: "Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën e paditësit me të cilën kishte kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë prej 15.248,00 euro. Kolegji i Apelit nuk pajtohet me këto gjetje të AL të AKP-së e as të Shkallës së parë të DHPGJSK-së. Fillimisht, kërkesa për pagat e pa paguara për periudhë kohore të caktuar nga paditësja, nuk është parashkruar në tërësi, por është e vërtetë se një pjesë e saj është parashkruar. Kërkesa e paditëses konsiston për periudhën 2004 deri më 2014. Megjithatë është e qartë se Shkalla e parë i ka ngatëruara këto dy kërkesa të cilat nuk janë të natyrës së njëjtë. Kolegji i Apelit vëren se kërkesa ka të bëjë me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 2004 deri më 2014, e jo për ndërpreje të parakohshme të marrëdhënies së punës. Kjo kërkesë tek AL i AKP-

së ishte parashtruar më 19 gusht 2014 që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave kreditore. Është e qartë se për tri vitet para 19 gushtit 2014, kjo kërkesë nuk është e parashkruar, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës edhe mund të jetë e parashkruar, nëse nuk ofrohet edhe ndonjë dëshmi shtesë për ndërprerjen e parashkrimit. Megjithatë, ishte i gabuar vlerësimi edhe e AL të AKP-së se kërkesa është parashkruar në tërësi. Kolegji i Apelit ka gjetur se paditësja kishte ofruar disa dëshmi në mbështetje të kërkesës së saj, por ato nuk janë të miftueshme për njohje të kërkesës së saj, sepse këto dëshmi kanë të bëjnë me lista të pagesave dhe me raporte bankare dhe nga këto prova nuk është e qartë se cila pagë është paguar e cila ka mbetur pa u paguar. Nga dëshmitë që tashmë janë në shkresat e lëndës është e qartë se paditësja kishte një raport juridiko civil me NSH-në dhe nuk është i vërtetë konstatimi i Shkallës së parë se kontrata e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës ishte për kohë të caktuar. Edhe këtu Shkalla e parë e ka ngatërruar kuptimin e nenit përkatës. Neni 3 i kontratës mbi veprën thotë: " S Sh obligohet që punët dhe detyrat prej nenit 1 të kësaj kontrate, t'i kryej në afat të caktuar". Këtu është fjala për shërbimet që ka të bëjë me kontabilitetin dhe bilansin përfundimtar të dorëzohen në kohë, por në asnjë nen të kësaj kontrate nuk është përcaktuar afati i vlefshmërisë së kontratës.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, ajo regjistrohët me numrin e ri C-IV-23-0070.

Me datë 07 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshoj një urdhër për paditësen, me të cilën është kërkuar që ajo të dorëzojë prova që dëshmojnë se gjatë cilës periudhë kohore ka ofruar paditësja shërbime pune, për cilën periudhë është paguar, dhe për cilën periudhë nuk është paguar.

Me datë 23 mars 2023, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrit. Në këtë parashtresë ajo pohon se që nga data 15 mars 2005 kishte lidhur kontratë mbi veprën me NSH DLB "Progres" Prizren, Nr.37/2005, në bazë të cilës ka kryer punët financiare dhe të kontabilitetit, ka përgatitur bilancin periodik dhe përfundimtar të NSH-së, si dhe likuidimin e detyrimeve të NSH-së ndaj organeve shtetërore. Tutje ajo pohon se kontrata e fundit për kryerjen e punëve të tilla ka qenë e dates 30.01.2013, Nr.6/1 dhe cila ka pasur vlerë deri 25 prill 2014. Në këtë parashtresë paditësja pohon se borxhi i mbetur për punët e kryera është 5,613.24 euro dhe atë për periudhën nga 01.01.2005 e deri 31.06.2014. Në këtë

parashtresë paditësja po ashtu ka kërkuar pagesën edhe të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit. Tutje në parashtresë ajo pohon se nuk qëndron pretendimi i të paditurës se gjoja paditësja nuk ka dhënë shërbime pune për NSH-në. Gjendja faktike e tregon të kundërtën, me ç'rast ajo i referohet dëshmive vijuese: deklaratës së tatimit në të ardhurat e korporatave, DLB-2006, pasqyra e tatimit për tremujorin e pare dhe të dytë per vitin 2006, deklarata e tatimit në të ardhura të korporatave, DLP viti 2006, 2007, trusti paguar nga DLB për vitet 2008 – 2013, formulari i deklarimit dhe I pagesës së TVSH-së për DLB për tërë vitin 2010, formulari i deklarimit vjetor 2012 për tatim në të ardhura për DLB, pasqyra e tatimit për tremujorin e pare dhe të dytë për vitin 2012 dhe 2013 për DLB, deklarim ivjetor i tatimit për DLB për vitin 2013, formulari i korespodencës me personin zyrtar të ATK-së, raporti i Raiffaisen Bank për pagat e paguara nga DLB për S Sh, për vitet 2007 – 2014.

Me datë 30 mars 2023, AKP-ja në bazë të urdhrin të Shkallës së I-rë e dorëzon një parashtresë dhe përgjigjet në parashtresën e fundit të paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se paditësja nuk ka paraqitur ndonjë argument të r i mbi të cilën do të mund ti mbështetëste pretendimet e saj. Në parashtresë ajo përsërit pretendimin se kërkesa e saj për pagesën e pagave të pa paguara është parashkuar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Me këtë parashtresë ajo dorëzon një tabelë që ndërlidhet me analizën e pagave të pa paguara deri më 31.08.2013, një listë të punëtorve dhe një kopje të kontratës mbi veprën të dates 30.01.2013.

Me datë 02 maj 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-23-0070, e aprovon pjesërisht ankesën e paditëses si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e obligon të paditurën që ti paguajë paditëses për vitin 2012 shumën 450.00 euro, për vitin 2013 shumën prej 1,185.00 euro dhe për vitin 2014 shumën prej 900.00 euro, ose në shumë të përgjithshme prej 2,535.33 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 253.00 euro ose shumën totale për pagesë prej 2,788.00 euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj me procedurën e likuidimit. Me pikën e dytë të dispozitivit Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar, ndërsa me pikën e tretë të dispozitivit e detyron të paditurën ti paguajë paditëses në emër të kompensimit të shpenzimeve të

procedures kontestimore shumë prej 268.00 euro, e cila shumë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në këtë çështje faktet vendimtare të rastit nuk janë kontestuese pasi që AKP-ja në parashtrirat e saja vetëm e konteston kërkesën për shkak të parashkrimit të saj. Andaj kontesti në mes të palëve është i natyrës së pastër ligjore ku pala e paditur pretendon se kërkesa kreditore për paga është parashkruar ndërsa pala paditëse pretendon se kjo kërkesë nuk është parashkruar dhe se i takon e drejta në paga. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se pagat e periudhës shtator 2011 deri gusht 2014 nuk janë parashkruar, ndërsa pagat tjera të mëhershme janë parashkruar. Shkalla e I-rë konstaton se duke u bazuar në kontratën e fundit mbi veprën të datës 30.01.2013, është vërtetuar se paditësja ka ofruar shërbime punë për palën e paditur, andaj kërkesa për pagesën e pagave për tri vitet e fundit nuk është parashkruar. Shkalla e I-rë konstaton se pala paditëse për vitin 2011 nuk është kompensuar për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor në shumë prej 450.00 euro (tri X 150 = 450 euro), për vitin 2012 është kompensuar më tepër në shumë prej 164.67 euro, për vitin 2013 nuk është kompensuar për muajin maj – dhjetor në shumë prej 1,200.00 euro (8 X 150 = 1,200.00 euro), meqenëse pala paditëse në vitin 2012 është paguar më tepër në shumë prej 164.57 euro, gjykata ka zbritur këtë shumë, duke ia aprovuar vetëm shumën prej 1,185.00 euro, dhe për vitin 2014 nuk është kompensuar për muajt janar – qershor në shumë prej 900.00 euro (6 X 150 = 900.00 euro). Përfundimisht Shkalla e I-rë ka ardhur në përfundimin se borxhi i përgjithshëm i palës së paditur ndaj paditëses për periudhën e cekur është në shumë prej 2,535.00 euro. Shkalla e I-rë konstaton se vendimi mbi të drejtën në interes ligjor është bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së LDHP-së, ndërsa vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës gjyqësore është bazuar në nenin 62 par 1 dhe 2 të LDHP-së.

Me datë 23 maj 2023, AKP-ja përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë C-IV-23-0070, të dates 02 maj 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit e paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Aktgjykimi nuk i përmbush kërkesat e nenit 54 të LDHP-së që ndërlidhen me prezentimin e gjetjeve faktike që kanë rëndësi material për këtë

rast. Në këtë ankesë AKP-ja konsideron se gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë konstitutit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit thekson se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit i aplikon në mënyrë të drejtë, afati i parë është afati për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës e që e bën kërkesën sit ë pranueshme. Ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësja ka kërkuar ta zbatojë në kërkesë, e që është afati i parashkrimit prej 3 viteve në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy afatet e referuara janë të ndara dhe të dallueshme, dhe se të dyja duhet të plotësohen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësja nuk ka saktësuar se cili nen i LDHP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja konsideron se DHPGJS-ja ka jurisdikcion vetëm për të verifikuar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, andaj kërkon nga DHPGJS-ja që edhe njëherë ti merr në konsideratë argumentet e ngritura nga Autoriteti i Likuidimit.

Në bazë të fletdorëzimit që ekziston në dosje, avokati i paditëses ankesën e AKP-së e ka pranuar me datë 16 qershor 2023, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-21-0679 të dates 16 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me urdhrin e lëshuar me datë 07 mars 2023, ka kërkuar nga paditësja të dorëzojë në Gjykatë prova shtesë në mbështetje të kërkesës së saj.



Paditësja me parshtrësën e saj të dorëzuar në DHPGJS me datë 23 mars 2023, si përgjigje ndaj urdhrorit ka dorëzuar të gjitha dokumentet të cilat ajo i është referuar në këtë parashtrësë: deklaratën e tatimit në të ardhurat e korporatave, DLB-2006, pasqyrën e tatimit për tremujorin e parë dhe të dytë për vitin 2006, deklaratën e tatimit në të ardhura të korporatave, DLP viti 2006, 2007, trusti paguar nga DLB për vitet 2008 – 2013, formulari i deklarimit dhe i pagesës së TVSH-së për DLB për tërë vitin 2010, formulari i deklarimit vjetor 2012 për tatim në të ardhura për DLB, pasqyra e tatimit për tremujorin e parë dhe të dytë për vitin 2012, dhe 2013 për DLB, deklarim vjetor i tatimit për DLB për vitin 2013, formulari i korespondencës me personin zyrtar të ATK-së, raporti i Raiffaisen Bank për pagat e paguara nga DLB për S Sh, për vitet 2007 – 2014.

Nga provat e administruara nga Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, vërtetohet se paditësja në bazë të kontratës mbi veprën e cila e fundit ishte me datë 30.01.2013, ajo kishte ofruar shërbime pune për NSH-në duke i kryer punët e kontabilitetit financiar dhe bilancet përfundimtare të NSH-së për periudhën nga data 15 mars 2005 e në vijim, e që në bazë të kontratës së fundit këto punë janë kryer deri në gusht të vitit 2014.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se pagat e kërkuara për periudhën nga viti 2011 e deri në vitin gusht 2014, nuk janë parashkruar për faktin se ende nuk kishte kaluar afati 3 vjet i parashkrimit të kërkesës në bazë të nenit 372 par.1 i LMD-së. Ndërsa pagat tjera të periudhës së mëhershme, konsiderohen të parashkruara për faktin se paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë prove që ato i ka kërkuar më herët në gjykatën kompetente.

Tutje Kolegji i Apelit i mbështet të gjeturat faktike të dhëna në arsyetimin ligjor të Aktgjykimit, lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit për këto tri vitet e fundit.

AKP-ja me mborjtjen në ankesë dhe me kundërpëgjigje, kërkesën e paditëses e konteston vetëm për shkak të parashkrimit, nuk ka kontestim shprehimor lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit.

Andaj mbi këtë bazë faktike dhe ligjore, me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar shumën e kërkuar në emër të pagave të pa paguara prej 2,535.33 euro, si dhe interesin ligjor prej 10% në shumën e borxhit kryesor prej 253.00 euro,

po ashtu edhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 268.00 euro, të cilat shuma duhet të paguhen nga AKP-ja, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, e në bazë të ninit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Pasi që tashmë AKP-ja e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 14 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 18 prill 2024.

Mr. Sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

---